



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:070707

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06628171

AC.nr.2511/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.M. nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av.R.M., me seli ne V., rruga “H.P.” nr.78, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e ushqimit gjatë punës, duke vendosur sipas ankesës të të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri, C.nr.452/21 të datës 20.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.452/21 i datës 20.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.452/21 të datës 20.03.2023, ka vendosur si vijon: *“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh.M. nga V., DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën nga data 15.12.2020 e deri me datë 31.10.2022 t’ia paguaj paditëses Sh.M. shumën prej 732.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 15.11.2022 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj shumën prej 104.00 euro, për përpilimin e padisë dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim”.*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, kurse aktgjykimi i atakuar me ankesë të anulohet ose të prishet aktgjykimi i atakuar me padi dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë është parashtruar nga paditësja përmes të autorizuarit të saj, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Sh.M. nga V., me datë 16.04.2021, ka parashtruar padi për kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, si dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 398 të LPK-së, (jashtë seancës) ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.452/21 të datës 20.03.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata përmes Kontratës së punës me numër 805/19 e datës 20.06.2019, të lëshuar nga e paditura vërtetoi faktin se paditësi, është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në institucionin parafillor “Foleja” në Vushtri dhe gjatë vitit 2020-2022 i njëjti ka punuar gjithsej 366 ditë pune. Gjykata ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike

dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe atë nga kontrata punës me numër 805/19 e datës 20.06.2019, vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në institucionin parafillor "Foleja" në Vushtrri dhe gjatë vitit 2020-2022 i njëjti ka punuar gjithsej 366 ditë pune.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*". Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes*". Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës*". Me paragrafin 5 përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*".

Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: "*Të punësuarve, (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim*". Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: "*MASh, SBAShK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023*".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*".

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, pasi që në nenin 87 të Ligjit të Punës, është përcaktuar se "*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3)*

vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, ndërsa paditësja kërkesën e saj e ka parashtruar për periudhën nga data 15.12.2020 e deri me datë 31.10.2022, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 16.04.2021 dhe precizuar me datë 15.11.2022.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.2511/2023, me datë 16.12.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.